



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 402 Prot.

Datë 17.07.2023

VENDIM

Nr. 1002, Datë 17.07.2023

“Mbi Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.07.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi dhe vendimmarrja në lidhje me Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, 27, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pasi shqyrtoi Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VËREN SE:

Më datë 14.07.2023, pranë Autoritetit të Konkurrencës, është protokolluar me shkresën nr. 669/5, Vendimi nr. 67, datë 14.07.2023, i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative, të nxjerra nga organet e disiplinës gjatë zhvillimit të procedurës së ecurisë disiplinore, të nisur në ngarkim të Sekretarit të Përgjithshëm, në institucionin Autoriteti i Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pasi u njoh me argumentet e paraqitura, bazën ligjore dhe dispozitivin e këtij Vendimi, konstatoi se ndodhemi në kushtet e tejkalimit haptazi të kompetencave lëndore nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sa i përket kërkesës për anulimin e aktit nr. 359/3 prot., datë 29.06.2023.

Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se, bazuar në nenin 59, pika 2 të ligjit nr. “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, organi administrativ publik kompetent për marrjen e vendimeve përfundimtare në lidhje me një konflikt pune në kuadër të rregullimeve që parashikon legjislacioni për shërbimin civil është Komisioni Disiplinor i ngritur pranë institucionit. Në zbatim të nenin 14 “Kompetencat e Komisionerit”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, KMSHC, ndryshe nga ish-Komisioni i Shërbimit Civil, nuk ka kompetenca thelbësore për zgjidhjen e një konflikti pune ndërmjet një institucioni publik dhe nëpunësit civil. KMSHC mund të hetojë, inspektojë, administrojë dhe mbikëqyrë çdo praktikë administrimi në çdo institucion në shërbimin civil e, në vijim, nëse çmon se ka shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil, me vendim me shkrim, të paralajmërojë institucionin përkatës, duke i lënë detyrat për përmirësimin e situatës apo të japë rekomandime, por në asnjë rast nuk gëzon tagrin për të zgjidhur në thelb konfliktin. Edhe në jurisprudencën gjyqësore për këto raste arsyetohet se “kur KMSHC urdhëron organin publik të kryejë një veprim administrativ, ndodhemi përpara marrjes së atributëve të organeve quasi gjyqësore nga ana e KSHMC e rrjedhimisht në tejkalim të kompetencave lëndore” (shiko ndër të tjera edhe Vendimi nr. 80-2021-1883, datë 11/06/2021 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë). Për pasojë, vendimi nr. 67, datë 14.07.2023 në lidhje me ato pjesë të tij që vendos ndaj Autoritetit të Konkurrencës detyrime që lidhen më thelbin e konfliktit do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsideratë nga Autoriteti i Konkurrencës.

Në lidhje me sugjerimin për përbërjen e Komisionit të Disiplinës, ngritur si shqetësim në vendimin nr. 67 dt. 14.07.2023 të KMSHC, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se ekziston mundësia e zëvendësimit të një pjese të anëtareve të këtij komisioni dhe e riparimit të kësaj problematike e cila, sidoqoftë nuk çon në pavlefshmëri të vendimmarrjes së deritanishme të Komisionit Disiplinor në çështjen në përkatëse.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 26 dhe nenin 27, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Të konfirmojë qëndrimin e Komisionit të Konkurrencës në mbledhjen nr. 15, data 27 qershor 2023 për nisjen e procedurës së ecurisë disiplinore për zj. Diana Dervishi.
- II. Të konfirmojë Kryetarin e Komisionit të Konkurrencës si përfaqësuesin e Komisionit të Konkurrencës në Komisionin Disiplinor të ngritur për këtë çështje.

- III. Të marrë në konsideratë Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil sa i përket përbërjes së Komisionit Disiplinor.
- IV. Të mos marrë në konsideratë Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil sa i përket rekomandimeve të tjera duke i konsideruar absolutisht të pavlefshme.
- V. Të ankimojë në Gjykatë Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS


Leida MATJA

()
Zv/Kryetar


Rezana KONOMI

()
Anëtar

Adriana BERBERI

()
Anëtar

Durim KRAJA

()
Anëtar

Denar BIBA

Kryetar

